

## **DOKUMENTE/EVIDENCA QË DUHET TË KETË INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

### **I.DOKUMENTE LIGJORE**

1. Ligji i Arsimit Parauniversitar
2. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
3. Nivelet e arritjes sipas shkallëve të arsimit parauniversitar
4. Aktet nënligjore ( udhëzime, vendime, rregullore, urdhra) që lidhen me arsimin të dala nga MASR, ASCAP, DPAP, DRAP,ZVA.
5. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës, të aspekteve të tjera që i vijnë shkollës nga ASCAP
6. Vendime, rregullore,urdhra që nxjerr drejtorja e shkollës vetë

### **II.DOKUMENTE QË LIDHEN ME MENAXHIMIN**

1. Plani afatmesëm i shkollës
2. Plani vjetor i shkollës
3. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore
4. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional
5. Statistikat e shkollës, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve/kursantëve
6. Plani i zhvillimit të brendshëm profesional
7. Plani financiar dhe përdorimi i fondeve nga shkolla
8. Të dhënat e burimeve njerëzore ( kualifikimi i stafit mësimor dhe ndihmës)
9. Dokumente që evidentojnë punën e organizmave të shkollës për: Bordin e Shkolla-së, Këshillin e mësuesve, ekipet kurrikulare dhe lëndore, këshillat prindërve klasë/institucion, qeverinë e nxënësve, Komisionin e Etikës dhe sjelljes, Komisionin e Disiplinës, Komisionin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, mësuesi kujdestar, psikologu, punonjësi social, polici i sigurisë, mjeku.
10. Karta e Performancës së shkollës
11. Raporti vjetor i shkollës
12. Raporti i vetëvlerësimit të shkollës
13. Amzat, regjistrat e shkollës, certifikatat, dëftesat, dëshmitë, diplomat që lëshon shkolla
14. Dosjet e vlerësimit vjetor të mësuesve nga drejtori i shkollës
15. Të dhëna të përpunuara në trajtë materialesh profesionale që kanë siguruar informacione nga fokus-grupet apo nga pyetësorë me mësues, drejtues të shkollës, nxënës, prindër, etj.
16. Dokumente që dëshmojnë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e shkollës me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, komunitetin dhe shoqërinë civile, si dhe me shkolla të tjera ose analoge brenda dhe jashtë vendit.
17. Dokumentacion që dëshmon se aktorë nga partnerët e përcaktuar janë pjesë e organizmave të shkollës ose që dëshmojnë se janë të përfshirë në jetën institucionale.
18. Dokumentacioni i veprimtarive të përbashkëta me institucione të tjera
19. Plani i shkollës për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e shkollës me institucionet e tjera

### **III.DOKUMENTE/EVIDENCA QË LIDHEN ME KURRIKULËN E ZBATUAR**

1. Plani i zhvillimit të orëve mësimore.
2. Orari mësimor
3. Programet lëndore.
4. Planet vjetore/tremujore

5. Planin vjetor lëndor/tremujor, aftësitë dhe temat ndërkurrikulare, si dhe projektet kurrikulare për cdo lëndë që mbështeten në dokumentet zyrtare
6. Tekstet shkollore, laboratorët dhe mjetet didaktike
7. Dokumentacion që dëshmon veprimtarinë e ekipeve lëndore, të instruktorëve dhe atij kurrikular, ku përfshihen të gjithë mësuesit dhe instruktorët e Shkollës-së.
8. Të dhëna të përpunuara nga dokumentacioni i vlerësimit të vëzhgimit të orëve mësimore të mësuesve nga drejtuesit e shkollës
9. Të dhëna të përpunuara në trajtë materialesh profesionale që kanë siguruar informacione nga fokus-grupet apo nga pyetësorë me mësues/instruktorë, drejtues të shkollës, nxënës, prindër.

#### **IV.DOKUMENTE/EVIDENCA QË DUHET TË KETË INSTITUCIONI PËR VLERËSIMIN**

1. Evidencat e vlerësimit që përdor mësuesi.
2. Teste/vlerësime tremujore.
3. Portofoli i nxënësit/mësuesit
4. Regjistrat e klasave.
5. Dokumentacion që dëshmon vlerësimin e detyrave të shtëpisë, vlerësimet me gojë dhe me shkrim në klasë, vlerësimin e produkteve të nxënësit.
6. Dokumentacion i shkollës për vlerësimet përfundimtare sipas Niveleve përkatëse përfundimtare që menaxhon vetë Shkollën, si dhe me rivlerësimin dhe përgjigjet e ankimeve të nxënësit.
7. Dokumentacion që lidhet me të dhëna dhe evidenca që krahasojnë vlerësimin që mësuesit i kanë bërë nxënësve dhe vlerësimeve të jashtme ( klasa e pestë, provimet e lirim, matura shtetërore rankimi i shkollës në nivel zonal, rajonal, kombëtar, apo nga vlerësime të jashtme PISA, TIMSS).
8. Të dhëna të përpunuara në trajtë materialesh profesionale që kanë siguruar informacione nga fokus-grupet apo nga pyetësorë me mësues, drejtues të shkollës, nxënës, prindër.